

**Prishtinë, 05 dhjetor 2006**

# Komunikatë për Shtyp

## **Rregullatorët për Energji të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë do të nënshkruajnë Memorandumin për Bashkëpunim**

Të premtën, me 1 dhjetor në Tiranë, është mbajtur takimi i parë rajonal në mes të Rregullatorëve për Energji të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës.

Zyra e Rregullatorit të Kosovës është prezantuar nga Kryesuesi i saj Dr. Nick Frydas.

Në këtë takim janë diskutuar çështjet e interesit të përbashkët si: shkëmbimi i praktikave rregullative dhe përvojave në mes të tri vendeve; pajtueshmëria e sistemeve të energjisë, njohja reciproke e licencave dhe çështjet në lidhje me harmonizimin e kornizave rregullative me qëllim të krijimit të një tregu të unifikuar të energjisë.

Gjithashtu është diskutuar për përgatitjen e tekstit përfundimtar të draft versionit të Memorandumit për Mirëkuptimit për bashkëpunim në mes të 3 agjencive rregullative, i cili do të nënshkruhet në janar 2007.